



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 261, datë 24.05.2023

PËR

**DEKLARIMIN E PËRFUNDUAR PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR TË
PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORE TË
POZICIONIT, PASURISË DHE FIGURËS PËR Z. {...}, ISH/KANCELAR NË DETYRË
NË GJYKATËN E RREHTIT GJYQËSOR BERAT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 24.05.2023, si u njoh me materialet e çështjes dhe relacionin “Për deklarinimin e përfunduar pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z. {...}, ish/kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrehtit Gjyqësor Berat”, përgatitur nga relatorja e procedurës së verifikimit znj.Brikena Ukperaj dhe pasi shqyrtoi propozimin e ardhur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ;

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 53, 55 dhe 83 të ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 424, datë 12.10.2020 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, dhe vendimin nr. 496, datë 21.10.2020 “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”, ka filluar procedurën e verifikimit për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, verifikimin e pasurisë dhe figurës për kancelarët në detyrë, ndër të cilët edhe për z.{...}, ish/kancelar i Gjykatës së Rrehtit Gjyqësor Berat.

2. Gjatë procedurës së verifikimit të zhvilluar nga relatori i caktuar me short, është konstatuar se z.{...} ka ndërruar jetë në dt. 08.02.2023, fakt që provohet nga të dhënat e çertifikatës së vdekjes dt. 17.02.2023 lëshuar nga ZGJC 2 Berat, përcjellë pranë relatorit nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, bashkëngjitur informacionit të dt.23.02.2023.

II. VLERËSIMI I KËSHILLIT MBI VIJUESHMËRINË E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT

3. Në pikën 1 të Kreut I, të Vendimit 424/2020 parashikohet se qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave më të hollësishme mbi procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ligjor në Gjykatën e Lartë dhe për ndihmës ligjor në gjykatat e apelit, si dhe të pasurisë dhe të figurës së tij, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative, veçanërisht ato të ligjshmërisë, transparencës, informimit, drejtësisë, paanësisë, objektivitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, mbrojtjes së të dhënave, konfidencialitetit e të sekretit shtetëror dhe të proporcionalitetit, për zbatimin e unifikuar të standardeve në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në bazë të pikës 2/iv, ky vendim rregullon procedurat e verifikimit edhe për kancelarin në detyrë, status i dhënë për ta nga neni 83 i Ligjit 98/2016 i ndryshuar.

4. Rrethana e faktit si më sipër, vdekja e palës, afekton ecurinë e kësaj procedure administrative, sipas parashikimeve të nenit 93 të Kodit të Procedurave Administrative, ku nën titullin: “Vdekja e palës, mbarimi i personit juridik”, parashikohet se : “ Nëse pala, person fizik, vdes gjatë zhvillimit të procedurës administrative që zhvillohet për një çështje të karakterit personal, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative, pa marrë një vendim përfundimtar për çështjen...”.

5. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, i pasurisë dhe figurës së kancelarit në detyrë, përbën çështje të karakterit personal të tij. Si të tilla, verifikimi i tyre nuk mund të vazhdojë, nëse pala, subjekti i procedurës ndërron jetë.

III. KONKLUZIONI

6. Bazuar sa më lart, Këshilli vlerëson se procedura e verifikimit ndaj z. {...}, duhet të deklarohet e përfunduar pa vendim përfundimtar. Kjo procedurë zhvillohet për një çështje të karakterit personal, e tillë që nuk mund të vazhdojë nëse pala e kësaj procedure, në rastin konkret kancelari në detyrë, ndërron jetë.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 90 dhe 97, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenet 59, pika 1, 80, pika 3 dhe 83 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 93 të Kodit të Procedurave Administrative dhe pikat 17, seksioni C, kreu IV, dhe 119, seksioni A, kreu XI të vendimit nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Deklarimin e përfunduar pa vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për z.{...}, ish/kancelar në detyrë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR